



Pranuar / Donesuar Prenjensje / Predato Received / Delivery	27-04	1	viti god year
Organ / Ujesta Organ / Jednica Org / Unit	SKPMSTHCK	2031/2021	Sasia Kolicina Quantity
			115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Anr.260/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.Nr.2358/2019 të datës 31.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën më numër A.nr.402/2019, të datës 16.07.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Sheshi "Adem Jashari", Nr.5, Mitrovicë, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 në paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.402/2019 e datës 16.07.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anulohet Përgjigja në Ankesë me numër 07-111/01-0047836-2/19 e datës 02.07.2019 e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Mitrovicën e Jugut.
- III. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër 07-111/0110022893/2019-3/2019 i datës 15.05.2019.

A r s y e t i m

Komuna e Mitrovicës së Jugut bazuar në Autorizimin e datës 15.03.2019 të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, me datë 21.03.2019 ka shpallur konkursin me Nr.01-07/111/010002298983/2019 për pozitën Drejtor i SHFMU "Anton Zako Çajupi", e në të cilin konkurs kanë aplikuar vetëm dy kandidatë, respektivisht ankuesja dhe

Drejtoria Komunale e Mitrovicës, me datë 15.05.2019 ka nxjerrë Njoftimin numër 07-111/0110022893/2019-3/2019, për përsëritje të konkursit për pozitën Drejtor i SHFMU "Anton Zako Çajupi" në Mitrovicën e Jugut, për shkak të mos pjesëmarrjes së mjaftueshme të kandidatëve

në konkursin me Nr.01-07/111/010002298983/2019 të datës 21.03.2019 për pozitën Drejtor i SHFMU "Anton Zako Çajupi".

Kundër këtij Njoftimi, ankuesja me datë 06.06.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Lidhur me ankesën e ankuses së datës 06.06.2019, Drejtoria Komunale e Arsimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut ka lëshuar përgjigje në ankesë me numër 07-111/01-0047836-2/19 të datës 02.07.2019, me të cilën është refuzuar si e pa bazuar ankesa e ankesës dhe e njëjta është udhëzuar mbi të drejtën e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, me Vendimin me numër protokollit 01-112/02-0043359/2019 të datës 22.05.2019, ka emëruar përkohësisht Ushtruese Detyre të Drejtorit të SHFMU „Anton Zako Çajupi“, në Mitrovicën e Jugut, deri në përfundimin e procedurës së rekrutimit për pozitën e Drejtorit të kësaj shkolle.

Ankuesja e pakënaqur me Përgjigjen në ankesë me numër 07-111/01-0047836-2/19 të datës 02.07.2019 të Drejtorisë Komunale të Arsimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, brenda afatit ligjor respektivisht më datë 16.07.2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 29.07.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë, me numër protokollit 3307/2019, të Komuna e Mitrovicës së Jugut, ndërsa me datë 21.08.2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokollit 3726/2019, se bashku me shkresat e bashkangjitura fq.1/4

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional për shkak të mos emërimit të anëtarëve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me ç'rast Këshilli me shkresën me numër protokollit 4038/2019 të datës 03.09.2019, ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së tij me numër A.nr.402/2019 të datës 16.07.2019, duke udhëzuar palën mbi të drejtën e ndjekjes së procedurës gjyqësore, në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Pas këtij njoftimi të Këshillit, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A. Nr.2358/2019 të datës 31.03.2021, i pranuar në Këshill me datë 08.04.2021, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses melihate Meha, ka anuluar Njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 03.09.2019 dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankuses të datës 16.07.2019.

Kolegji për vendosje të drejtë të ankesën ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 402/2019 me numër protokollit 3163/2019 e datës 16.07.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës: Aktgjykimin A. Nr.2358/2019, të datës 31.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, Ankesa e datës 06.06.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimin numër 07-111/0110022893/2019-3/2019 15.05.2019; Vendimi me numër protokollit 01-112/02-0043359 i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Përgjigje në Ankesë e datës 02.07.2019; Konkursi me Nr.01-07/111/010002298983/201920.03.2019; Aktvendimi CP.Nr.320/2014i datës 19.12.2017, i Gjykatës Themelore në Mitrovicë; Kërkesë me numër protokollit 15/2019 e datës 03.04.2019, Vendimi i datës 23.05.2019, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratë e Punës se



ankueses se email i datës 05.09.2019 nga sipas kërkesës sipas kërkesës së KPMSHC për sqarime shtesë, Përgjigje në ankesë e datës 21.08.2019 me numër protokoll 3726, Kërkesa për fillimin e rekrutimit e datës 20.02.2019- MAP-SHCK-01, Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën e Drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët, e Organografi i SHFMU "Anton Zako Çajupi" CV e ankueses e datës 04.04.2019, Ekstrakt i lindjes E23362552 i datës 27.03.2019, Certifikatë Shëndetësorë e datës 29.03.2019 për ankuesen, Certificate nën hetime e datës 25.03.2019 PNr.1769/2019, Vërtetim i datës 28.03.2019; Letër reference, e ankueses e datës 03.04.2019, Vendimi me numër ref.40/2018 i datës 01.03.2016; Diplomë universitare e ankueses Nr.81 e datës 25.09.1995, Diplomë për master nr.079/16 e datës 26.07.2016. Plani Zhvillimor i Shkollës 2018 nga ankuesja, Kërkesa për punësim e Ekstrat i Lindjes E90169795 i datës 01.04.2019, Vërtetim i datës 01.04.20189, Referencë e Certifikatë Shëndetësorë e datës 29.03.2019 për Certifikatë nën hetime e datës 29.03.2019 PN.Nr/Kr 1853/2019, Diplomë Universitare nr.117 e datës 09.09.2013; Plani zhvillimor i Shkollës 2019; Licenca e Mësimdhënësit nr.100002598, Certifikatë trajnimi nr.29008/035 e datës 18.12.2016.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka analizuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar sepse:

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesja pretendon së Komuna e Mitrovicës së Jugut ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Edukativo Arsimor dhe Aftësues, dhe të Kryetari i Komunës pa marrë fare për bazë rezultatet dhe përvojën e punës së ankueses, ka emëruar një mësuese të kësaj shkolle si Ushtrueses të Detyrës së Drejtorit të SHFMU "Anton Zako Çajupi", e cila sipas ankueses nuk posedon përvojë të nevojshme dhe kualifikim të duhur profesional. Propozon që Këshilli të anuloi Përgjigjen në Ankesë me numër 07-111/01-0047836-2/19 të datës 02.07.2019 të Drejtorisë Komunale të Arsimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut si dhe Vendimin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut me numër protokoll 01-112/02-0043359/2019 të datës 22.05.2019, për emërimin e si Ushtruese e Detyrës së Drejtorit të SHFMU „Anton Zako Çajupi“.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se në konkursin e shpallur të datës 21.03.2019, nga Komuna e Mitrovicës, për pozitën Drejtor i SHFMU „Anton Zako Çajupi“, në Mitrovicën e Jugut, kriteret e konkursit kanë qenë:

- Te ketë te kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (se paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar
- Të ketë licence të rregullt të mësimdhënësit ose të jetë në procedure të licencimit
- Të ketë se paku 3 vite përvojë punë në arsim ose në institucione të arsimit
- Te ketë te përfunduar me shkueses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqjeje ne administrim dhe menaxhim

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar së në konkursin e datës 21.03.2019 për pozitën Drejtor i SHFMU „Anton Zako Çajupi“ në Mitrovicën e Jugut, kanë aplikuar vetëm dy kandidatë dhe se pas kësaj fazë nuk është ndërmarr asnjë veprim tjetër lidhur me procedurën rekrutuese në fjalë, për shkak të numrit të pa mjaftueshëm të aplikueseve. E mbi ketë bazë, Drejtoria Komunale e Arsimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, bazuar në nenin 2 paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Edukativo Arsimor dhe Aftësues, me datë 15.05.2019 ka bërë

Njoftimin numër 07-111/0110022893/2019-3/2019 lidhur me numrin e pamjaftueshëm të kandidateve për pozitën e shpallur Drejtor i SHFMU "Anton Zako Çajupi" në Mitrovicë dhe ri përsëritje të procedurës së rekrutimit për këtë pozitë, e si rrjedhojë Kolegji konstaton se organi i punësimit ka vepruar në pajtim me Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 22 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Nëse numri i aplikacioneve të pranuar është me pak se pesë (5), procedura e rekrutimit ndërpritet nga njësia e personelit dhe një shpallje e re e rekrutimit për pozitën e njëjte publikohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, si dhe nenin 2 paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo Arsimor dhe Aftësues ku përcaktohet se: 7.Nëse brenda 45 ditëve nuk behët zgjedhja e drejtorit/zëvendës drejtorit, atëherë DKA shpall konkurs të ri, e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i pa bazuar.*

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor së Kryetari i Komunës së Mitrovicës pa marrë fare për bazë rezultatet dhe përvojën e punës së ankueses, ka emëruar një mësuese të kësaj shkolle në pozitën e Ushtrueses së Detyrës së Drejtorit të SHFMU "Anton Zako Çajupi", Kolegji në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civilë si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo Arsimor dhe Aftësues, si dhe nisur nga rëndësia e pozitës së Drejtorit të Shkollës, ka konstatuar së Vendimi i kundërshtuar i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës për emërimin e përkohshëm të Ushtrueses së Detyrës së Drejtorit të SHFMU "Anton Zako Çajupi" është në pajtim me nenin 30 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/ L-149 për Shërbimin Civil ku parashihet se: *4. Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj, si dhe nenin 2 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo Arsimor dhe Aftësues ku përcaktohet se: 8.Nëse në afatin e paraparë prej 3 muajsh, nuk zgjidhet drejtori caktohet ushtruesi i detyrës së drejtorit sipas legjislacionit në fuqi, e si rrjedhojë Kolegji vlerëson së pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar.*

Bazuar në nenin 43 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Kolegji konstaton së nëpunësi civil apo kandidati në një procedurë konkurrimi i cili pretendon së është bërë ndonjë parregullsi gjatë procesit të rekrutimit, ka të drejtën që të parashtrij ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, brenda institucionit përkatës, i cili ka për detyrë të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën, Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se Përgjigja në Ankesë me numër 07-111/01-0047836-2/19 e datës 02.07.2019 e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Mitrovicën e Jugut, është nxjerrë nga organi jo kompetent dhe si e tillë nuk përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ ashtu siç kërkohet me nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Nisur nga ky konstatim, e duke u bazuar në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 dhe nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në pikën II të dispozitivit.

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si duke u bazuar në kompetencën e Këshillit. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente-Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A. Nr. 260/2021

Rushit KAJTAZI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuese
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës;
- Drejtorisë së Arsimit Komunal, në Mitrovicë;
- Arkivit të KPMSHCK-së

